



UNIVERSITETI / UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVİCË

SYLLABUSI: ANALIZ FINANCIARE - PROGRAMI: INXHINIERI MEKANIKE		
Fakulteti:	Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	
Departamenti:	Inxhinieri Ekonomike	
Niveli:	Bachelor	
Kodi i lëndës:	302 IE	
Lënda:	ANALIZ FINANCIARE	
Statusi lëndës:	Obligative (O)	(Obligative apo zgjedhore)
Semestri:	V	(Dimëror/Veror)
Fondi i orëve:	2+2	(Sipas programit të aprovuar)
ECTS:	5	(Sipas programit të aprovuar)
Orari/Salla:	E ejte, 12 ³⁰ -14 ⁰⁰ , K103	
Viti akademik:	2024/25	
Mësimdhënës/e:	Ass. Dr.sc. Safet Abdullahu	
Asistent/e:		
Kontaktet:	Mësimdhënës/e	Asistent/e
Email:	safet.abdullahu@umib.net ,	
Telefon:	+383/49/699 338	
P ë r s h k r i m i i l ë n d ë s	Lënda analiza financiare trajton analizën financiare të kompanisë përmes pasqyrave kryesore financiare si: Bilancin e gjendjes, Pasqyrën e të ardhurave, Pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe Pasqyrën e kryegjësë. Analiza e këtyre pasqyrave mundëson që të vlerësohet gjendja financiare, suksesi si dhe perspektiva e kompanisë. Në këtë kurs trajtohen edhe ndikimet që kanë informatat nga pasqyrat financiare në marrjen e vendimeve menaxheriale në kompani. Gjithashtu, përmes Analizës së Pasqyrave Financiare kerkohet të arrihet skanimi i gjendjes realefinanciare përmes treguesve kryesore financiare dhe dhenja e rekomandimeve rreth shëndeshmerise financiare të ndërmarrjes.	
Q ë l l i m i	Ky kurs ka për qëllim tu ofrojë studentëve që të kuptojnë rëndësinë e përpilimit dhe të analizës së pasqyrave financiare, informatat e së cilave do t'u shërbejnë menaxherëve të ndërmarrjes për marrjen e vendimeve. Qëllim tjetër i këtij kursi do të jetë edhe aftësimi i studentëve që përmes analizës financiare të jenë në gjendje të pasqyrojnë gjendje reale financiare përmes analizave matematikore bazuar në informatat e pasqyrave financiare/.	

R e z u lt a t e t e p r i ts h m e t ë n x ë n ie s	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: 1. Formoj opinionin e tij në lidhje me pasqyrat financiare dhe nevojën e analizës së këtyre pasqyrave me qëllim të vlerësimit të gjendjes dhe suksesit të kompanisë. 2. Vlerësoj efektin e informatave nga këto pasqyra financiare në marrjen e vendimeve menaxheriale në kompani. 3. Vlerësoj efektet e informatave nga pasqyrat financiare për shfrytëzuesit e brendshëm dhe të jashtëm. 4. Prezantoj në formë tabelare, grafike dhe përmes modeleve të tjera opinionet e tij mbi problemet/rezultatet e analizës së tyre.
--	---

	Javët	Tema
P r o g r a m i	Java - I	Hyrje në Analizën financiare
	Java - II	Ndërmarrja dhe rrethina e saj financiare
	Java - III	Raportet financiare sipas SNRF dhe SKK1
	Java - IV	Analiza e bilancit të gjendjes
	Java - V	Analiza e pasqyrës së të ardhurave dhe rrjedhës së parasë
	Java - VI	Metodat e paraqitjes, analizës dhe të vlerësimit të situatës Financiare
	Java - VII	Diskutime dhe vlerësimi i parë
	Java - VIII	Analiza e strukturës financiare - Treguesit financiar
	Java - IX	Analiza e aktiviteteve afariste (operuese)
	Java - X	Analiza e aktiviteteve investuese dhe aktiviteteve financiare
	Java - XI	Analiza e dinamikës financiare të firmës - Pragu i rentabilitetit dhe leverazhi
	Java - XII	Konsolidimi financiar dhe shkaqet e çrregullimeve financiare
	Java - XIII	Çmuarja e pasurisë së ndërmarrjes, parimet dhe metodat
	Java - XIV	Diskutime/Seminare/Prezantime
	Java - XV	Diskutime dhe vlerësimi i dytë

Literatura	
L i t e r a t u r a	1.Prof.dr.Shefket Jakupi, Dr.Bedri Statovci, "Financial Statement Analysis" Ulcinj 2016 2.Prof.dr.Shefket Jakupi; Mr.HidajeteJashari-Lutfiu "Advanced Financial Analysis" Ulcinj 2015 3. John J.Wild, K.R Subramanyam, Robert F.Hasley "FINANCIAL STATEMENT ANALYSIS" McGraw - Hill - 2006 4.A.Helfert 2.Erich D.B.A., Techniques of financial analysis, (7 ed.) (Croatian Edition MATE, Zagreb, 1997) 5.K.Zager - L.Zager, analysis of financial statements, Second Edition, Zagreb 2010

M e t o d o l o g j i a e m ë s i m d h ë n j ë s	Në kuadër të këtij kursi, orët tjera shtesë të ngarkesës mësimore studentët duhet t'i kalojnë në studime të pavarura. Studentët të ndarë në grupe inkurajohen që të përgatisin punime me të dhënat origjinale të ndërmarrjeve. Pasi ta përfundojnë punimin janë të obliguar që ta prezantojnë punën e tyre.			
	Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)			
	Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
	Ligjërata	2	15	30
	Ushtrime teorike	2	15	30
	Punë praktike	3	3	9
	Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
	Ushtrime në terren	1	2	2
	Teste, kollokfiime, seminare	2	2	4
	Detyra të shtëpisë	3	2	6
	Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	3	12
	Përgatitja përfundimtare për provim	3	3	9
	Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
	Projektet, prezantimet, etj	2	2	4
	Totali			125

V l e r ë s i m	Vlerësimet periodike: Pritet që studentët të marrin pjesë në vlerësime sipas kohës së planifikuar.		
	Detyrat dhe prezantimet/seminaret: kërkohet që të marrin pjesë në projekte në grup. I gjithë grupi duhet të kontribuojë në prezantimet e njëri-tjetrit në mënyrë që të shprehin pikëpamjet e tyre për çështjet e diskutimit.		
	Testet/Kollokviumet (Testi i parë); (Testi i dytë); (Testi i tretë)	20% 20%	
	Test praktik gjatë ushtrimeve (Ese)		
	Punim seminari	20%	
	Interpretimi dhe prezantimi i krijimtarisë artistike dhe i punëve të tjera.		
	Detyrat dhe kurset gjatë semestrit.	5%	
	Praktikë profesionale		
	Tjetër [specifiko], Vijueshmëria	5%	
	Provimi final	30%	
	Totali	100%	
	Nota përfundimtare:	Pikët (%)	Nota
		91 – 100	10
		81 - 90	9

	71 - 80	8
	61 - 70	7
	51 - 60	6

P o l i t i k a t a k a d e m i k e	Pjesëmarrja e studentëve në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Mësimdhënësi duhet të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve gjatë kohës zyrtare si dhe përmes emailit. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që u është caktuar, ti dorëzojnë punimet dhe ti prezantojnë ato.
	Caktohen kriteret për vijueshmëri të rregullt dhe rregullat e mirësjelljes gjatë organizimit të mësimit. Puna me kompjuter Punimet seminarike, duhet të punohen dhe shkruhen me kompjuter. Në punime janë të obligueshme respektimi i kriterëve qoftë për aspektin vizual ashtu edhe përmbajtësor të punimeve të kërkuara. Gjatë punimeve kërkohet që të respektohen rregullat drejtshkrimore. Etika në mësim Duhet të kërkohet të respektohen rekomandimet e mësimdhënësit. Detyrat konsultimet dhe gjithaçka tjetër të jenë në pajtueshmëri me rregulloren dhe statusin e fakultetit. Nuk tolerohen kopjimet ose çfarido tjetër që ka tebeje me thyerjen e etikes akademike. ● Afatet Në marrëveshje me studentët do të përcaktohen afatet e dorëzimit të punimeve. Nuk do të ketë tolerancë për vonesë në dorëzimin e punimeve. Mosardhja në orën kur është shpjeguar detyra nuk e arsyeton studentin për mosdorëzim të punimit. Afati do të jepet më herët. Po që se do të udhëtoni jashtë vendit, atëherë duhet të dorëzoni punimi më herët. Studenti/ja ka të drejtë të kërkojë konsultim me profesorin sa herë e shih të arsyeshme dhe të nevojshme për kryerjen e punimit të tij/saj. ● Rregullat e mirësjelljes dhe politikat akademike : - o pjesëmarrje aktive e studentëve në ligjërata dhe ushtrime - o pjesëmarrje në diskutim, komente dhe shprehje e lirë e opinionit, mendimit dhe qëndrimit akademik (me argumente) - o e obligueshme puna e pavarur dhe shfrytëzimi i burimeve shtesë të informacionit (web-faqet e ndryshme shkencore, revista shkencore, përmbledhje punimesh të konferencave etj) - o respektimi i orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve, pa e cenuar lirinë akademike (telefonat celularë pa zë) - o respektimi i fjalës, mendimeve dhe ideve të kolegëve, - o nuk lejohet ardhja me vonesë dhe dalja pa ndonjë arsye të qëndrueshme nga ligjërata, ushtrime, testi apo provimi, - o përgatitja dhe mbajtja e ligjëratave përkatëse, (obligim i mësimdhënësit). - o nëse studenti mungon më shumë se katër here pa arsye në ligjërata dhe ushtrime, nuk merr nënshkrimin për vijueshmëri. - o studenti nuk mund t'i nënshtrohet provimit pa dokument zyrtar, - o nëse student është i pakënaqur me notën e fituar, ka të drejtë ankese me shkrim dekanit, brenda dy dite të punës, pas shpalljes së rezultateve, Statuti i UMIB-it nëse studenti nuk i përfill rregullat në provim, përdorë mjete që nuk lejohen, vlerësohet me notë negative.